



Për më shumë informacion
www.vet4gseb.eu



 Co-funded by the
the European Union

PARTNERITETI I AFP-SË PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË GJELBËR DHE INTELIGJENTE NË NDËRTESA



CHAMBER OF INSTALLATION SPECIALISTS IN
BULGARIA - "TOGETHER WE CAN DO MORE"



Qëllimi i projektit

Objektivi kryesor i projektit VET4GSEB është të transferojë përvojën dhe praktikat e mira në fushën e arsimit dhe formimit profesional nga vendet europiane (Bullgaria dhe Turqia) tek vendet e tjera pjesëmarrëse në projekt, përkatësisht Shqipëria, Ukraina, Armenia dhe Gjeorgjia. Çfarë është shumë e rëndësishme është ndarja e dijeve dhe ideve ndërmjet partnerëve.

Synimi I VET4GSEB është që ofruesit e AFP-së të pajisen me zgjidhje të përshtatura sipas nevojave, me materiale trajnimi, mjete dhe udhëzues në mënyrë që t'u mundësojë atyre të përditësojnë dhe përmirësojnë programet dhe praktikat e tyre të trajnimit.



Objektivat dhe synimet e vendosura në Strategjitë dhe Politikat e BE-së për Energjinë por dhe ato të vendeve pjesëmarrëse kanë çuar në ndryshime në tregun e punës për projektuesit dhe instaluesit e aplikacioneve inteligjente dhe sistemeve të energjisë së rinovueshme në ndërtesa. Sektori ka nevojë për profesionistë me aftësi të reja - jo vetëm për njohuri dhe aftësi në fushën e instalimeve inteligjente të ndërtesave dhe sistemeve të BRE-ve, por edhe aftësi të buta, ndërpersonale dhe sipërmarrëse.

**QENDRA E ENERGJISË NË SOFIE (SEC)
NGA BULLGARIA**



**PEOPLE IN FOCUS NGA
SHQIPËRIA**



**DHOMA KOMBËTARE E ZEJTARISË
NGA SHQIPËRIA**



**DHOMA E SPECIALISTËVE TË
INSTALIMIT NË BULLGARI - CISB
NGA BULLGARIA**



**QENDRA E EFIÇIENCËS
ENERGJITIKE GJEORGJI (EECG)
NGA GJEORGJIA**



**SHOQATA "ZHVILLIMI I
QËNDRUESHËM DHE MJEDISI
(SUDEAS) NGA TURQIA**



**UNIVERSITETI KOMBËTAR I
SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT
TË UKRAINËS (NUBIP) NGA
UKRAINA**



**SHOQATA TANIQ NGA
ARMENIA**



VET4GSEB KICK-OFF

Projekti VET4GSEB filloi më 26-27 Janar, 2023, në Sofje, Bullgari, e organizuar nga Sofia Energy Center (SEC). Gjashtëmbëdhjetë pjesëmarrës nga gjashtë shtete partnere morën pjesë, duke përfshirë pjesëmarrësit online nga Ukraina.

Në këtë takim u diskutuan aspekte kyçe duke përfshirë :

- Plani i Projektit & Menaxhimi – Udhëhequr nga SEC
- Analiza e Nevojave & Mjetet e Trajnimit – Nga CISB & SUDEAS
- Strategjitë e Impaktit dhe Shpërndarjes së Informacionit


Ky event shënoi krijimin e bazës së projektit, duke nxitur bashkëpunimin përmes sesioneve produktive dhe rrjetëzimit joformal.



Co-funded by the
the European Union

REZULTATET E PROJEKTI

1. Raport mbi Nevojat e Tregut të Punës për elektriciçistët dhe instaluesit e sistemeve të BRE-ve në ndërtesa.




https://vet4gseb.eu/results/#flipbook-df_2116/1/



Gjetjet e rëndësishme:

- Hendeku I Aftësive: Mungesa e specialistëve të trajnuar në instalimet e sistemeve të energjisë së rinovueshme.
- Nevojat për trajnim: Kurrikula të vjetërsuara dhe standarde të paqëndrueshme të certifikimit.
- Aftësitë thelbësore: Ekspertizë e fortë teknike, aftësi dixhitale dhe aftësi komunikimi me klientët.

Kemi zhvilluar një pyetësor në gjashtë shtete, dhe kemi hulumtuar mbi nevojat e kompanive dhe profesionistëve në sektorin e energjisë së rinovueshme, duke u fokusuar tek elektriciçistët dhe instaluesit e FV dhe sistemeve gjeotermike në ndërtesa.



Niveli i Kompetencave të Specialistëve & Trajnerëve




CHAMBER OF INSTALLATION SPECIALISTS IN BULGARIA - "TOGETHER WE CAN DO MORE"

SUSTAINABLE DEVELOPMENT AND ENVIRONMENT ASSOCIATION



REZULTATET E PROJEKTIT

2. Ekipi ynë ka përgatitur një raport të gjerë mbi **Metodologjitë Më Të Mira** të Trajnimit për të pajisur profesionistët me aftësitë e duhura.




https://vet4gseb.eu/results/#flipbook-df_2114/1/




3. Mbledhja e të dhënave mbi **Zgjidhjet Inovatore Teknike** për zbatimin e instalimeve elektrike inteligjente dhe sistemeve FV në ndërtesa.

4. U përpilua një raport mbi **Zgjidhje të Reja për Aplikimin e FV-ve.**



Përdorimi i Sistemeve Inteligjente të Energjisë Elektrike në Ndërtesa



Cilësia dhe Efikasiteti i Sistemeve FV në Vendet Partnere

REZULTATET E PROJEKTIT

5. Pajisëm profesionistët me **aftësitë e nevojshme** për aplikimin e sistemeve inteligjente të energjisë në ndërtesa.



6. Ofrimi i **trajnimeve** që kombinojnë **dijet teknike** në sektorin e ndërtesave inteligjente dhe sistemeve të energjisë së rinovueshme.




8. U siguroam që ofruesit e AFP-së të jenë të përgatitur të përballen me **kërkesat në rritje** për profesionistë të kualifikuar në këtë sektor.

7. U fokusuar në zhvillimin e **aftësive thelbësore të buta, aftësive ndërpersonale** dhe **kompetencave sipërmarrëse**.



PËRPILIMI I MODULEVE TË TRAJNIMIT DHE LANCIMI I NJË KURSI ONLINE



Ne lancuam me sukses një kurs online informues dhe formues për ofruesit e AFP-së në fushën e BRE-ve në faqen tonë të web. Palët e interesuara u regjistruan dhe zhvilluan kursin duke e menaxhuar vetë kohën e tyre dhe u pajisën me çertifikatë pasi kaluan testet me sukses.



TRYEZË E RRUMBULLAKËT NË ÇDO SHTET PARTNER - Projekti VET4GSEB organizoi tryeza të rrumbullakta në të gjitha shtetet partnere. Këto evente bënë sëbashku ekspertë, ofruesit e AFP-së dhe palët e interesuara, pjesë të industrisë për të diskutuar nevojat e zhvillimit të aftësive në energjinë e gjelbër dhe inteligjente në ndërtesa. Njohuritë e mbledhura ndihmuan në formësimin e materialeve të trajnimit, duke siguruar që ato të adresojnë kërkesat reale të tregut dhe të mbështesin përparimin e arsimit profesional.



Trajnimi Ndërkombëtar i Trajnerëve

Trajnimi përfundimtar pilot i projektit VET4GSEB u zhvillua në Bursa, Turqi, në datat 25-26 qershor 2024. Trajnimi përdori metoda inovative dhe mjete dixhitale për të pajisur pjesëmarrësit me aftësi thelbësore mbi sektorin e energjisë së gjelbër, duke promovuar një të ardhme të qëndrueshme.



Takim Partnerësh në Bursa, Turqi

Në 27 Qershor, 2024, të gjithë partnerët e konsorciumit u mbledhën në Bursa, Turqi, për të diskutuar mbi qëndrueshmërinë e projektit dhe përmirësimet e mundshme.






Tirana, Albania Oct.24



Kyiv, Ukraine Oct.24



Armenia Oct.24

TRAJNIMI KOMBËTAR I TRAJNERËVE

Eventet Kombëtare të Trajnimit të Trajnerëve në çdo shtet partner u organizuan duke u bazuar në modulet e Kursit Online. Gjatë këtyre sesioneve (ballë për ballë), pjesëmarrësit, **trajnerët e AFP-së, sipërmarrjet vendase, OJF-të dhe universitetet**, u pajisën me zgjidhje të përshtatura, materiale trajnimi, mjete dhe udhëzues për të përmirësuar dhe përditësuar **programet dhe praktikat e tyre të trajnimit**. Pjesëmarrësit që përfunduan të gjithë modulet dhe kuicet, patën shansin të pajisen me Supplementin e Certifikatës Europiane, duke treguar arritjet dhe përkushtimin e tyre në përmirësimin e aftësive në këtë fushë të rëndësishme.



U mbajtën **9 sesione trajnimi në 6 shtete** partnere, ku u ndoq një program i **mësimdhënies së përzier**, duke kombinuar modulet online me sesionet ballë për ballë. Në formularin e vlerësimit, pjesëmarrësit theksuan nivelin e tyre të lartë të kënaqësisë duke sugjeruar shtimin e përmbajtjes vizuale. Një total **192 trajnerë** përfunduan kursin, **u kualifikuan** duke e kaluar objektivin prej 88 personash.

europass Certificate supplement **VET4GSEB**

- Title of the certificate ¹**
Example: City & Guilds Level 2 Progression Award in Early Years Care and Education
- Translated title of the certificate ²**
Example: City & Guilds Ebene 2 Progression Zeugnis in Erziehung (de)
- Profile of skills and competences**
List the skills and competences acquired by the holder of the certificate. This list should start as follows: "A typical holder of the certificate is able to:" and should include a list of about 5 to 15 items using action verbs to describe skills and competences.
Example:
The holder of the certificate is able to:
Core units
- understand the role of the childcare worker



Tbilisi, Georgia Oct.24



ORGANIZIMI I KONFERENCAVE PËRFUNDIMTARE

U organizuan me sukses 6 konferenca përfundimtare për projektin VET4GSEB, duke sjellë në pah aktivitetet dhe arritjet tona të rëndësishme. Këto evente treguan sesi VET4GSEB mbështeti ofruesit e AFP-së në Bullgari, Shqipëri, Armenia, Gjeorgji, Turqi dhe Ukrainë me materiale të përshtatura trajnimi në sektorin e ndërtimit dhe energjisë së rinovueshme, duke u fokusuar në impaktin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të projektit.



Lexoni artikullin këtu



Sofje, Bullgaria
Nëntor 2024



Lexoni artikullin këtu



Co-funded by the
the European Union



Kontaktet dhe për më tepër informacion www.vet4gseb.eu

Partnerët e VET4GSEB:

Projekti është i përbërë nga një konsorcium prej 8 partnerësh : Bullgaria, Shqipëria, Armenia, Gjeorgji, Turqia dhe Ukraina

Koordinator: Sofia Energy Centre

